



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres të Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 287/2024  
Datë: 24/07/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7/01 mars 2019), në pajtim me nenin 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenin 18 të Ligjit nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënese të agjencive të pavarura, si dhe pas pranimit të propozimit nga Agjencia për Ndihme Juridike Falas, me numër të protokollit 226/02 të datës 23.07.2024, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

#### V E N D I M

#### Për themelimin e Zyrave Mobile për Ndihmë Juridike Falas

1. Aprovohet propozimi i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për themelimin e zyrave mobile për ndihmë juridike falas.
2. Themelohen Zyrat Mobile për Ndihmë Juridike Falas në komunat: Podujevë, Klinë, Vushtrri, Lipjan, Shtime dhe Rahovec.
3. Zyrtarët e Zyrës nga pika dy (2) e këtij vendimi obligohen që detyrat dhe përgjegjësitë t'i kryejnë në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit përkatës në fuqi.
4. Vendi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

#### A r s y e t i m

Ministria e Drejtësisë, me datë 23.07.2024, përmes shkresës me numër të protokollit 226/02, nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, ka pranuar propozimin për themelimin e zyrave mobile për ndihmë juridike falas në komunat: Podujevë, Klinë, Vushtrri, Lipjan, Shtime dhe Rahovec.

Nisur nga fakti se nenin 18 (paragrafi 1) i Ligjit nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, parashihet se Zyrat mobile për ndihmë juridike falas themelohen nga Ministria përgjegjëse për drejtësi me propozim të Agjencisë.

Me qëllim që qytetarëve të komunës së Podujevës, Klinës, Vushtrrisë, Lipjanit, Shtimes dhe Rahovecit tu mundësohet ndihma juridike falas dhe rrjedhimisht qasja në drejtësi, si dhe faktin se propozimi i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas është në pajtim me legjislacionin në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi iu dërgohet:

- Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme të MD-së;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.